

**VENDIM**  
**Nr. 790, datë 12.12.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1034, DATË 16.12.2020, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR  
RIFORCIMIN E PALLATIT TË KULTURËS ‘DEDE NDUE LAZRI’, NË  
BASHKINË LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 1034, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 104 000 000 (njëqind e katër milionë) lekë pa TVSH, për rihforcimin e pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë, në formën e transfertës të pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**